



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PUKE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1876 prot

Pukë, më 22 10.2024

VENDIM
NR. 50 , datë 16.10. 2024

« PËR RISHQYRTIM TË VKB NR. 35 DATË 16.08. 2024 "PER DHENIEN NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR" PËR SHESH- DEPOZITIMI TË PËRKOSHËM TË MATRIALEVE TË NDRYSHME ME SIPËRFAQE 0.2 HA NË PARCELËN 28/A NË EKONOMINË PYJORE MUNELLË » DHE NDRYSHIM I NR. TË PARCELËS NGA 28/A Në 28/D »

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja "b" dhe 1.2, shkronjat "a" dhe "c", nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Ligjin nr.8480, date 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike", Ligjin nr.107/2014 date 31.07.2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ne Ligjin nr.8761 data 02.04.2001 "Për miratimin e "marrëveshjes së koncensionit të formës "bot" ndërmjet ministrisë së ekonomisë publike dhe privatizimit dhe shoqërisë së të drejtës turke "ber-oner" për disa objekte të industrisë së bakrit dhe të kromit, si dhe për dhënien e disa stimuljeve dhe garancive për koncensionarin e kësaj marrëveshjeje"

Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 433 date 08.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te Bashkive te fondit pyjor e kullisor publik.", V.K.M-ve nr. 888, datë 27.12.2022, "Për rastet e dhenjes ne perdorimi dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit ,procedurat dhe dokumentacioni perkates per ndryshimin e siperfaqeve dhe paksimin ne volum nga fondi pyjor kombetar apa zgjerimin e tyre; VKM-ve nr. 559, datë 29.07.2022 "Përpërcaktimin e cmimeve tarifave per dhenjen ne shfrytezim/Perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike si dhe per prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore", Udhezimin e Ministris te Mjedisit Nr. 1 date 09.06.2016 "Per rregullat, procedurat e kerkimit, te shqyrtimit e miratimit te kerkesave per dhenie ne perdorim te fondit pyjor dhe kullisor publik", si dhe Urdherin e Kryetarit bashkise Nr.166 date 05.04.2024 per hartimin e evlersimit teknike ekonomik.

Me propozim te Kryetarit te Bashkise Keshilli Bashkiak :

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies në përdorim nga fondi pyjor dhe kullisor të sipërfaqeve prej 0.2 ha pjese e pasurise Nr.397 vol.3 faqe 14 ne zonen kadastrale 2150 qe ndodhet ne ngastren Nr.

- 28/d ne ekonomine pyjore Munelle ,per shesh depozitimi te matrialeve inerte te perkoshem nga subjekti BERALB shpk .
2. Vlera vjetore e dhenjes ne perdorim me kontrate qeraje te jete sipas studimit te raportit te vlersimit tekniko-ekonomik te bazuar ne piken 12 shtocen 1 VKM Nr.559 datë 29.07.2022 “Përpërcaktimin e cmimeve tarifave per dhenjen ne shfrytezim/Perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike si dhe per prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”
 3. Afati i dhenjes ne perdorim eshte 10 vjete.
 4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtori e Menagjimit te Pyjet e kullotat,dhe Bujqesine.
 5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.
 6. Vendimi u shpall me date 18.10.2024.
- Vota te vlefshme gjithsej 11
Vota pro 10 , vota kunder 0 , vota abstenim 1

SEKRETARI
Hazbi Terbuni



KRYETARI
Gjon GJOKA



Gen. sek. Këshillit r.H. Terbu

04.11.24

[Handwritten signature]



1876/3

04.11.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr.733/1prot.

Shkodër, më 01.11 2024

Lënda: Mbi vendimin Nr.50, datë 16.10.2024 të Këshillit të Bashkisë Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji Nr.107/2016 dt.2.10.2016 "Për Prefektin" i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", në mbështetje të nenit 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, nenit 27 pika 5, neni 54/e/1, neni 55/3/4, neni 64/c të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr.57/2020 "Për pyjet" neni 25/ç, Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1 datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", VKM Nr.433, datë 8.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive te pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim te Ministrise së Mjedisit e të ish/komunave/bashkive" pika 50, shtojca 48, VKM Nr.559/2022 "Për përcaktimin e çmimeve, tarifave për dhënie në shfrytëzim /përdorim te fondit pyjor/kombetar per veprimtari ekonomike si dhe per prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore", shtojca nr.1, pika 12, (kartela e pasurisë së paluajtshme nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për pasurinë Nr.397, ZK.2150, numri i pemëve 0), materialit të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Pukë Nr.1896/3prot date.22.10.2024, analizoi **VKB Puke Nr.50, datë 16.10.2024** rishqyrtim i VKB Nr.35, datë 16.08.2024 "Mbi dhënie në përdorim nga fondi pyjor (numri i pemëve 0) të sipërfaqes prej 0.2 ha, ekonomia pyjore, 28A ekonomi pyjore Munellë, për shesh depozitimi të përkohshëm të materialeve inerte, subjektit BERALB, sh.p.k" duke korrigjuar numrin e parcelës nga 28a në 28d.

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

